



**QENDRA  
KINEMATOGRAFIKE  
E KOSOVËS**

Ref. nr.	912/2021
Data	19.11.2021
Datum	
Date	
Neskrifti	D.B
Petris	
Signature	
Prishtinë - Pristina	

KD. Nr.02/2021

Date: 19.11.2021

Në bazë të Ligjit për Kinematografinë Nr. 2004/22 nenit 29, Këshilli Drejtues në përbërje prej: Luan Daka, Anisa Ismaili, Alban Nimani, Besim Ugzmajli dhe Zethane Bahtiri –anëtarë, duke vepruar sipas propozimit të drejtorit të Qendrës Kinematografike të Kosovës nxjerr këtë:

**VENDIM**

Emërohen anëtarët e Jurisë Vlerësuese për projektet filmike të konkursit të vitit 2021 në kategorinë për film të metrazhit të gjatë artistik, debutant dhe koproduksion minor. Anëtarët e Jurisë Vlerësuese për kategoritë e lartecekura janë:

1. **Domenico Laporta - Kryeredaktor i Cineuropa-s;**
2. **Blerta Zeqiri – Regjisore;**
3. **Lenka Tyrpáková - Programere ne Festivalin e Karlovy Var-it;**
4. **Isa Qosja – Regjisor;**
5. **Doruntina Basha – Skenariste;**
6. **Sudeep Sharma - Programer ne Festivalin e Sundance;**
7. **Yllka Gashi – Aktore.**

Anëtarët e Jurisë Vlerësuese gjatë vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekteve janë të obliguar të zbatojnë Ligjin për Kinematografinë, Statutin e Qendrës Kinematografike të Kosovës, Rregulloren për punën e Jurisë Vlerësuese dhe Rregulloren për subvencionimin e projekteve filmike nga QKK. Juria Vlerësuese vlerësimet e veta në formë të shkruar ia paraqet QKK-së. Anëtarët e Jurisë Vlerësuese në mbledhjen e parë e zgjedhin Kryesuesin e Jurisë Vlerësuese, i cili do të udhëheqë procedurat e vlerësimit të projekteve. Për punën e kryer të gjithë anëtarët do të paguhen sipas honorarit të përcaktuar me Rregulloren nr. 08/2016 për punën e Jurisë Vlerësuese për projektet filmike që subvencionohen nga QKK.

**Vendimi i dërgohet:**

-anëtarëve të KD-së;

-arkivit të QKK-së.

-anëtarëve të përfshirë në këtë vendim

**Luan Daka**

*Luan Daka*  
Kryesues i mbledhjes së KD-së

